



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:108338
Datë: 20.10.2020
Numri i dokumentit: 01218901

C.nr.1176/18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi-Rexhepi në çështjen juridike të paditëses M.L. nga fshati Komuna Viti, të cilin me autorizim e përfaqëson av Visar Musa nga Ferizaj, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit – BKS- me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Dren Hoti, në çështjen për kompensimin e dëmit, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur, më datë 21.09.2020 , në prezencën e te autorizuarit te paditësit dhe në prezencën e përfaqësuesit të paditurës, mori kurse me datën 20.10.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET padia e paditëses M.L. nga fshati Komuna Viti, si e bazuar dhe **DETYROHET** e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit – BKS- me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 15.03.2019 t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej **8.290 €** edhe atë:

a. Dëmin jo material:

- a) Për invaliditet të përkohshëm shumën prej 800 €
- b) Për dhimbje trupore –fizike shumën prej 4,100 €
- c) Për frikën e shkaktuar shumën prej 3,000€

b. Dëmin material dhe jo material:

- a) Për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë shumën prej 150 €
- b) Për rehabilitim klimaterik shumë prej 240 €

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumat e miratuara në lartësi prej **1.700.00€**.

III. DETYROHET e paditura që paditësit të i paguaj shumat e cekura në pikën **II**, të diapozitivit, në shumë të përgjithshme prej 8.290€ (tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë euro), të gjitha me kamatën ligjore prej 8%, nga data e përpilimit të ekspertizës 24.07.2019, deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 983 €, të gjitha në afat prej 15 dite, pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

I autorizuari i paditëses me datë 03.12.2018 ka ushtruar padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë me kontest kompensim dëmi, dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar mbetet në tersi pranë padis, ka deklaruar se meqë baza juridike e kërkesëpadisë nuk ka qenë kontestuese nga ana e të paditurës ngase ka qenë e mbështetur në prova relevante, në raport me dëmin që ka pësuar paditësja i propozon gjykatës që të miratoje në tersi kërkesëpadinë e precizuar, pasi e njëjta është e bazuar me ligjin e sigurimit të 04-L/18 i cili është në fuqi prej datës 23.06.2011, bazën e kërkesëpadisë sa i përket kamatës si në kërkesëpadi shpenzimet e procedurës dhe atë për dy ekspertiza mjekësore shumen prej 203 euro, për përpilim të padis shumën prej 156 euro, për seancat e mbajtura 676 euro për dy seancat e shtyera me propozim të paditurës me 50% 135.20 euro , kurse sa i përket ofertës nga e paditura e ka kundërshtuar si të pa pranueshme në raport me natyrën e lëndimeve të paditëses dhe pasojat e këtij rasti, andaj i propozon gjykatës që të aprovoje kërkesëpadinë në tersi si të bazuar.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancën gjyqësore si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar meqenëse nga dy ekspertizat që janë nxjerre në këtë procedure si dhe nga sqarimet që i bëri sot eksperti drejtpërdrejtë në seancën rezulton se kemi të bëjmë me lëndime të rënda trupore pa

pasoja, pasur parasysh moshën dhe llojin e lëndimeve me qëllim që kjo çështje të lidhet me pajtim gjyqësor i ofron ofertën në lartësi prej 2000 euro sa i përket bazës juridike e njëjta nuk është kontestuese, kontestuese mbetet lartësia e kërkesëpadisë shumë e kërkuar sot për kompensimin nga përfaqësuesi i palës paditëse konsideron se janë tejet të larta dhe nuk janë në harmoni me lëndimet e paditëses, i propozon gjykatës që në rastin e vendosjes të ketë parasysh ofertën tonë rregulloren e BQK-së që ka përcaktuar kriteret për kompensim praktiken gjyqësore edhe përfundimisht kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoje pjesërisht dhe përtej shumë 2000 euro shumë tjera të kërkuar nga paditësja të refuzojë si të pa bazuar kamatën ta përcaktojë në lartësinë e mjeteve të deponuar mbi 1 vit pa destinim të caktuar duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit dhe lidhur me shpenzimet të aplikoj parimi e suksesit në procedurë të palëve sipas nenit 452 të LPK-së ashtu që shpenzimet të njihen pjesërisht .

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë administrimin e provave: padia C.nr 1176/18 e datës 03.12.2018, kërkesa drejtuar të paditurës, kontrata mbi kompenzimin e dëmit nr 17/2018 e datës 13.08.2018, raporti i aksidentit nr 2018 CFT-468 e datës 10.08.2018, raportet mjekësore në emër të ekspertizës, ekspertiza mjekësore e datës 13.01.2020, ekspertiza mjekësore e datës 24.07.2019,

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të secilës veç e veç si dhe konform nenit 8 të LPK-së, dhe bindjes së lire të gjykatës, Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Gjykata, në këtë procedurë ka gjetur se ndërmjet ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesë padisë, nuk është kontestuese se aksidenti ka ndodhur me datë 10.08.2018, nuk është kontestuese se në këtë aksident paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore, por vetëm lartësia e kërkesëpadisë, nga administrimi i provave kallëzimi penal me nr 2018-CFT-468 dhe fakti se e paditura kishte detyrim dhe përgjegjësi civile në kuptim të nenit 940 të LMD-së për shpërblimin e dëmit jo material dhe material nga aksidenti i dt.10.08.2018, është vërtetuar fakti se aksidentin e ka ndodhur me dëme materiale dhe lëndime trupore ku ishin të përfshira dy automjete, këtë aksident e ka shkaktuar derisa njësia I ishte duke qarkulluar me automjet nga Ferizaj në drejtim të Gjilanit me të arritur tek pompa Petrol për shkaqe të panjohura humb kontrolli mbi automjet kalon në anën e kundërt të drejtimit të lëvizjes dhe me pjesën e perparme e godet njësien II në pjese e anës së majtë e cila qarkullonte nga drejtimi i

kundërt Gjilan Ferizaj , lëndime kishte pësuar paditësja M.L., andaj e paditura e ka kontestuar lartësinë e kërkuar nga ana e të autorizuarit të paditësve.

Se në këtë aksident paditësja pa fajin e saj ka pësuar lëndime të rënda trupore, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga mendimi i ekspertit Dr.A.T. –ortoped i cili mendimin e ka dhënë në formë të shkruar më dt.13.01.2020 në këtë gjykatë pas ekzaminimit të drejtpërdrejt dhe në bazë të dokumentacionit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e i cili ka konstatuar se paditësja ka pësuar këto lëndime trupore: Ndrydhje të kafazit të kraharorit, thyerje e brinjës së dytë të anës së majtë të gjoksit pa largim i cili lëndim karakterizohet si lëndim i rëndë trupor, e të cilën ekspertizë palët ndërgjyqëse nuk e kontestuan.

Se paditësja ka përjetuar dhimbje fizike, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga mendimi i ekspertit Dr.M.H. –ortopedi datës 24.07.2019, i cili ka konstatuar se paditësja ka pësuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë 30 min, dhimbje fizike të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej rreth 3 ditë, të intensitetit të mesëm 30 ditë dhe të intensitetit të ulët që kanë zgjatur përafërsisht ka edhe sot e kësaj dite posaçërisht gjatë sforcimit fizik dhe ndryshimeve klimatike, andaj gjykata duke u nisur nga lloji i dhimbjeve, intensiteti dhe koha e zgjatjes së dhimbjeve, vendosi që shuma prej 4,100 € është në harmoni të plotë me dhimbjet e përjetuara dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Se paditësja në këtë aksident ka përjetuar frikë, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e ekspertit të psikiatrisë Dr. V.S.A. Psikiatër, e cila mendimin e dha në forma të shkruar në këtë gjykatë më dt. 24.07.2019 dhe konstatoi se paditësja në momentin e aksidentit ka pësuar frikë primare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensiteti të lartë e cila ka zgjatur për 24 orë, frikë të intensitetit të mesëm e cila ka zgajtur pothuajse 4 javë dhe që ka kaluar në frikë të intensitetit të ulët e cila ka zgajtur edhe për 4 muaj, andaj gjykata duke u nisur nga lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës ka vlerësuar se kompensimi në lartësi prej 3,000 € është i drejt dhe adekuat për frikën e pësuar.

Se paditësja ka pasur, nevojën për rehabilitim fiziatriko-psikik prej 15 ditë, këto fakte gjykata i vërtetoi nga mendimi i ekspertëve të datës 24.07.2019 që është bazë për kompensimin e demit të tillë, andaj gjykata vendosi që të miratoj shumën prej 240 € e cila shumë është në përputhje me nevojën e paditësit për terapi fizikale.

Se paditësja pas këtij aksidenti ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar këtë fakt gjykata e vërtetoi nga mendimi i ekspertëve të datës 24.07.2019, në të cilën ekspertizë është përcaktuar se paditësja ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 35 javë ditësh, andaj gjykata vlerësoi se shuma prej 150 € është në proporcion me nevojën për ushqim të përforcuar të paditëses.

Se paditësja si pasojë e këtij aksidenti nuk ka pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor dhe shëmtim trupor, gjykata është bazuar në ekspertizën mjekësorë të punuar nga ekspertët Dr.M.H. dhe Dr. V.A.S. të datës 24.07.2019, të cilat kanë konstatuar se tek paditësja shëmtim trupor nuk ka, për këtë arsye edhe refuzoi kërkesëpadinë e paditësit lidhur me shëmtimin trupor.

Se paditësja pas këtij aksidenti ka pësuar invaliditet të përkohshëm këtë fakt gjykata e vërtetoi nga mendimi i ekspertëve të datës 24.07.2019, në të cilën ekspertizë është përcaktuar se paditësja ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 35 javë ditësh, andaj gjykata vlerësoi se shuma prej 800 € është në proporcion me nevojën për ushqim të përforcuar të paditëses.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit jo material dhe material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të neneve 136, 159, 169, 177, dhe 961 të LPK-së, duke u bazuar provat e bashkangjitura të cilat janë administruara si kallëzimi penal me nr 2018-CFT-486 e datës 10.08.2018 si dhe fakti se përfaqësuesi i të paditurës nuk e ka mohuar faktin se shkaktar i këtij aksidenti ka qenë i siguruari i tyre.

Gjykata ia ka falur besimin ekspertizës mjekësore të punuar nga Dr.M.H. dhe Dr. V.A.S. të datës 24.07.2019, ngase ekspertiza i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore, të cilat janë administruar si prova në këtë çështje juridike.

Gjykata e refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses mbi shumën e miratuar në lartësi prej 1.700.00€ pasi që shumat e kërkuara ishin shuma tepër të larta e të cilat nuk përkojnë me asnjë praktikë gjyqësore dhe nuk janë në harmoni me kriteret e kompanive të sigurimit këtë konkluzion gjykata e bazoi duke marr parasysh llojin e lëndimit të paditëses, dhimbjet e

përjetuara si dhe pasojat tjera të aksidentit, e tërë kjo duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të mjekësisë si dhe krahasimin e praktikave gjyqësore lidhur me lëndimet dhe pasojat e ngjashme të këtij karakteri, e duke u bazuar në nen.323 të LPK-së, në vlerësimin e lire ka ardhur në përfundim se shumatat e gjykuara në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë shuma reale dhe në përpjesëtim me dëmin e theksuar nga paditësi për shkak të dhimbjeve të përjetuara fizike.

Gjykata i analizoi theksimet e të autorizuarit të paditësit, i cili i propozoj gjykatës që ta miratoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses duke theksuar se shumatat e kërkuara janë në harmoni me kriteret të cilat aplikohen nga kompanitë e sigurimit dhe praktika gjyqësore, sepse paditësja ka pësuar lëndime trupore pa fajin e saj, përgjegjëse për të cilën është e paditura dhe ka obligim të përmbushjes së detyrimeve dhe po ashtu shtoi se kërkesëpadia është në përputhje të plotë me dispozitat e LMD-së dhe se si e tillë duhet të miratohet në tërësi, e këtyre theksimeve gjykata pjesërisht ua dha besimin e plotë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata i analizoi edhe theksimet e të autorizuarit të t 'paditurës, i cili i propozon gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta refuzoj mbi shumën e ofruar për marrëveshje gjyqësore pasi që shumatat e kërkuara si në padi janë shumë të larta dhe se nuk përkojnë as me kriteret e kompanive të sigurimit e as me praktikat gjyqësore në lidhje me lartësinë e kompenzimit për raste të tilla apo të ngjashme, këto theksime gjykata pjesërisht i morri si të bazuara e të cilat kishin të bënin lidhur me lartësinë e shumës së kompenzimit, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u theksua më lart u vërtetua se paditësi si pasojë e lëndimeve të shkaktuara në aksidentin e cekur më lart, ka pësuar dëm material dhe jo material në shumatat e caktuara dhe përgjegjësinë për këtë dëm në rastin konkret e mban e paditura, nga baza e auto përgjegjësi rrespektivisht në mbështetje të nenit 19 të LSDA-së, si dhe duke u bazuar në nenin 136 , nenit 173 par.1, 179 dhe neni 183 të LMD-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit Gjykata me kërkesën e paditësit dhe në bazë të nen.382 të LMD-së, e detyroi të paditurin që paditësit në shumatat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën prej 8% pasi që me Ligjin mbi marrëdhëniet e Detyrimeve në kuptim të detyrimit që rrjedh nga dëmi i shkaktuar si dhe kamatën lidhur me këtë rast e llogariti nga data 24.07.2019 prej datës kur është bërë ekspertiza mjekësore dhe gjykata është bindur se ekziston dëmi i tillë, e deri në pagesën definitive.

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditësit të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 983€ edhe atë: 104€ për përpilimin e padisë, 203€ për dy ekspertiza mjekësore, 676 € për 5 përfaqësime nga ana e avokatit, ndërsa e refuzoi pjesën tjetër të shpenzimeve si të pabazuara, gjykata vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1,453 dhe 449 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.1176/18 e datës 21.10.2020

Gjyqtarja

Mirlinda Bytyqi- Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.